



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivory	26. 01	2023	3	vll god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMVBHUK	960/2023		112	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1179/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1179/2022 të datës 14.12.2022 të parashtruar nga ankuesi Astron Dreshaj në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "shkelje e së drejtës në pagë", në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 26.01.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.1179/2022 e datës 14.12.2022 e parashtruar nga ankuesi Astron Dreshaj.

**A r s y e t i m**

Ankuesi Astron Dreshaj, Zyrtar i Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 14.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 8036/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së Menaxherit të Personelit me numër protokolli 8417 të datës 13.12.2022, për harmonizimin e koeficientit nga gjashtë (6) në shtatë (7).

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh së pretendimet ankimore të ankueses kanë për objekt çështjen e realizmit të koeficientit të pagës, thekson faktin së Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti hynë në fuqi me date 05.02.2023. Me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera





për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publikë, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.

Për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 është përcaktuar së gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.

Andaj, për sa u tha me sipër dhe duke marr parasysh faktin se pas parashtrimit të ankesës nga pala ankuese kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, Kolegji i Këshillit konstaton se objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, ngase edhe nëse do të kishte vendimmarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pagës nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, si dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrativ, si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1179/2022

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi Bajraktari



Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, Astron Dreshaj ;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

